



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-111/01-6563  
Datë 05.02.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294 dhe nenin 13 të Rregullores (QRK) numër 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Pranimit për zhvillimin e procedurës së vlerësimit për Grupin e Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë sipas konkursit me numër 01-111/01-6563 të datës 05.02.2026.
2. Komisionin e Pranimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Kushtrim Brahimaj – Kryesues (Menaxher i Burimeve Njerëzore)
  - 2.2. Arben Koshi – Anëtarë (Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare)
  - 2.3. Ali Sadiku – Anëtarë (Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Orize)
  - 2.4. Emanuell Prenrecaj – Anëtarë (Kryeinfermier i Mjekësisë Familjare)
  - 2.5. Gentiana Çollaku – Anëtare (Doktor i Mjekësisë)

Zëvendësues të anëtarëve të komisionit:

- 2.1. Trëndelina Shehu Hasi – Kryesuese (Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore)
  - 2.2. Leonora Juniku – Anëtare (Zëvendësdrejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare)
  - 2.3. Violeta Xërxa Thaqi – Anëtare (Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare në QKMF)
  - 2.4. Bekim Hyla – Anëtarë (Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Skivjan)
  - 2.5. Vala Kastrati – Anëtare (Doktor i Stomatologjisë)
3. Komisioni i Pranimit ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin profesional të kandidatëve që përfshin testimin me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i kandidatëve apo teknikë tjetër ekuivalente dhe të përshtatshme për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale, si dhe intervistën me gojë në përputhje me dispozitat e Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294 dhe Rregulloren (QRK) numër 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.
  4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Ardian Gjini  
  
Kryetar i Komunës së Gjakovës

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit të Pranimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit